

VENDIM
Nr. 701, datë 10.10.2012

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
TIRANË-ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Tiranë-Elbasan.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen tokë 22 744 (njëzet e dy mijë e shtatëqind e dyzet e katër) m², me vlerë 13 240 804.72 (trembëdhjetë milionë e dyqind e dyzet mijë e tetëqind e katër pikë shtatëdhjetë e dy) lekë, për objekte me vlerë 61 775 138 (gjashtëdhjetë e një milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e njëqind e tridhjetë e tetë) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 75 015 942.72 (shtatëdhjetë e pesë milionë e pesëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e dyzet e dy pikë shtatëdhjetë e dy) lekësh.

4. Shpenzimet procedurale në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 75 015 942.72 (shtatëdhjetë e pesë milionë e pesëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e dyzet e dy pikë shtatëdhjetë e dy) lekësh, të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave, pranë Bankës së Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.

6. Shpronësimi të fillojë më 15.10.2012.

7. Për objektin, për të cilin në kolonën përkatëse është bërë shënimi “Leje ndërtimi”, pronari të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë dorëzuar pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar dokumentacionin e plotë tekniko-ligjor.

8. Për objektet, për të cilat në kolonën përkatëse është bërë shënimi “Proces legalizimi”, poseduesit e këtyre objekteve të kompensohen, për efekt shpronësimi nga DPRR-ja, në bazë të vendimit nr. 563, datë 3.8.2011 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

9. Për objektet, për të cilat në kolonën përkatëse është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, pronarët të kompensohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të rifreskuar të pronësisë që do të dorëzojnë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

10. Për pasuritë, për të cilat në kolonën përkatëse është bërë shënimi “Proces regjistrimi”, pronarët respektivë të likuidohen, për efekt shpronësimi, pasi të përfundojë procesi i regjistrimit dhe në bazë të dokumentacionit të plotë dhe të rifreskuar të pronësisë, që do të dorëzojnë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

11. Për pasuritë e trajtuara në pikën 10 të këtij vendimi, Autoriteti Rrugor Shqiptar, para likuidimit të pronarëve, të mbajë përsëri korrespondencë me zyrën vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të vërtetuar përfundimin e procesit të regjistrimit.

12. Autoriteti Rrugor Shqiptar të bëjë likuidimet e pronarëve në bazë të pikave 7, 8, 9, 10 dhe 11 të këtij vendimi.

13. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Tiranë dhe Elbasan, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’u vihet në dispozicion nga

Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

14. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Tiranë dhe Elbasan, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

15. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha